



THIRRJE PËR PJESËMARRJE
KONFERENCË SHKENCORE
KOMBËTARE

**“THEMELUESIT E KOMEDISË SHQIPE NË
GJYSMËN E PARË TË SHEKULLIT XX”**
**(Aspekte gjuhësore dhe letrare të fillesave të
komedisë shqipe: Perspektiva kritike)**

25 TETOR 2025
SALLA E KONFERENCAVE “TEODOR LAÇO”
FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË
UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË



Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë në Universitetin e Korçës, në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, organizojnë Konferencë Shkencore Kombëtare, në kuadër të projektit institucional “Themeluesit e komedisë shqipe nën dritën e kërkimit shkencor, botimit dhe artit skenik”, të mbështetur nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Ftohen studiuesit, profesorët dhe doktorantët në fushën e gjuhës, të letërsisë dhe të studimeve kulturore që të marrin pjesë në këtë Konferencë Shkencore.

Konferenca do t'i zhvillojë punimet në këto tematika:

- Figurat themelore të komedisë shqiptare: Kristo Floqi, Andon Zako Çajupi, Mihal Grameno, Foqion Postoli, Dhori Koti, Ilo Mitkë Qafëzezi etj.;
- Elementet e komizmit (karakteret dhe kontradiktat komike);
- Ndikimi i konteksteve historike dhe sociale në zhvillimin e komedisë shqiptare në pjesën e parë të shekullit XX;
- Qasje kritike dhe teorike në analizën e teksteve komike;
- Aspekte gjuhësore dhe stilistike në analizën e teksteve komike;
- Studime krahasuese dhe qasje ndërdisiplinore në komedinë shqipe.

Konferenca do të zhvillohet më 25 tetor 2025, në sallën e konferencave “Teodor Laço”, në Fakultetin e Edukimit dhe të Filologjisë, Universiteti “Fan S. Noli” Korçë.

Gjuha e konferencës:

- Gjuha angleze
- Gjuha shqipe.

DATA TË RËNDËSISHME

Data e zhvillimit të konferencës: 25 tetor 2025

Afati përfundimtar i dorëzimit të abstrakteve: 20 shtator 2025

Njoftim në lidhje me pranimin e abstrakteve: 30 shtator 2025

Publikimi i programit të konferencës: 5 tetor 2025

Dorëzimi i punimi të plotë pas konferencës: Dhjetor 2025

Abstrakti/ Punimi i plotë dorëzohet në adresën elektronike:

departamentiigjuhesdheiletersise@unkorce.edu.al

(Tema dhe përmbledhja dorëzohen në gjuhën shqipe).

Kumtesat mund të përgatiten nga një autor ose grup autorësh.

Materialet e kësaj konference do të botohen në një përmbledhje të veçantë nga Universiteti “Fan S. Noli”, e pajisur me ISBN elektronike dhe do të publikohen në hapësirën kushtuar botimeve elektronike në faqen zyrtare të Universitetit.

KOMITETI SHKENCOR I KONFERENCËS

Prof. dr. Valter Memisha

Prof. dr. Shaban Sinani

Prof. as. dr. Jonela Spaho

Prof. as. dr. Eris Rusi

Prof. as. dr. Evalda Paci

Dr. Ilir Shyta

KOMITETI ORGANIZATIV I KONFERENCËS

Dr. Aida Mosko

Dr. Alda Cicko

Dr. Erinda Papa

Dr. Olger Brame

Dr. Valbona Sinanaj

Msc. Eftiona Bylykbashi

Modeli i përmbledhjes:

Formati i faqes: A4. Margjinat: lart e poshtë: 2,5 cm; djathtas e majtas: 2.5 cm

Titulli i punimit: (12 pt Times New Roman, Bold, i qendërzuar, me shkronja të mëdha (UPERPERCASE))

Emrat e autorit/ëve: (Me shkronja të mëdha, 12 pt Times New Roman, në qendër)

Institucioni ose Departamenti dhe Universiteti (12 pt Times New Roman, në qendër)

E-mail (për komunikim): 12 pt Times New Roman, në qendër, i rrafshuar në të dy skajet.

Përmbledhja: (deri në 250 fjalë; 12 pt Times New Roman, Bold, Justify, Hapësira mes rreshtave 1.5)

Fjalët kyçe: 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (12 pt Times New Roman, Normal)